



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 2100/1 prot

Përmet, më 04.07.2025

Lënda: Kthim përgjigje

TIRANË

Në mbështetje të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar ju bëjmë me dije se i gjithë informacioni që ju kërkon gjendet në linkun e mëposhtëm:

https://openprocurement.al/sq/tender/list/inst_id/48?

Ju faleminderit,

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 2116/1 Prot

Datë 02/07/2025.

Lënda: Kthim përgjigje.



Në përgjigje të kërkesës Tuaj datë: 2 Korrik 2025, me objekt: "Kërkesë për informacion" të kërkuara sipas pikave si më poshtë:

- 1. Emrin e subjektit/kompanisë që ka kontratë me Bashkinë për grumbullimin, transportin dhe/ose trajtimin e mbetjeve për vitin 2023 – 2024.**
 - Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta Urbane në Bashkinë Përmet nuk është i kontraktuar me subjekte private por realizohet nëpërmjet sektorit publik të pastrim-gjelbërimit.
- 2. Destinacioni final i mbetjeve pas grumbullimit (landfill, impiant për trajtim, transferim për riciklim, incenerim, etj) si dhe cdo informacion tjetër të rëndësishëm që lidhet me skemën e menaxhimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Përmet.**
 - Sasia e mbetjeve urbane të grumbulluara depozitohet në vënd-depozitimin e mbetjeve, i cili ndodhet rreth 12 km nga qendra e qytetit Përmet, në krahun e majtë të rrugës Piskove-Pagri rreth 3 km nga rruga nacionale Përmet- Këlcyrë.

Duke ju falenderuar.

KRYETARE E BASHKISË
Alma HOXH





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 2328/1 prot

Përmet, më 04.08 2025

Në përgjigje të shkresës suaj datë 20.06.2025 protokolluar me tonën me nr 2328 prot datë 21.07.2025 ju informojmë si më poshtë:

.Listën e HEC-eve (emrat e tyre, lumenjtë dhe degët e lumenjve mbi të cilat po ndërtohen, apo operojnë) që ndodhen në territorin e bashkisë?
Në fondin pyjor nën administrimin e Bashkisë Përmet dhe në kullosat në pronësi të Bashkisë Përmet, nuk ka subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e prodhimit të energjisë përmes centraleve hidroenergjetike (HEC-eve).

Duke qenë se në territorin e Bashkisë Përmet nuk operojnë apo nuk janë ndërtuar HEC-e, rrjedhimisht edhe pyetjet e tjera të parashtruara në kërkesën tuaj, të cilat lidhen me vendndodhjen, burimet ujore, të ardhurat nga këto subjekte, ndikimin në mjedis, marrëveshjet me komunitetin dhe të dhëna të tjera teknike apo financiare, nuk gjejnë zbatim në rastin tonë dhe mbeten pa objekt.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi

NËN KRYETAR

Florand HASANI

Sheshi "Abdyl Frashëri" Nr. 1, +35581322254; web: bashkia-permet.gov.al; e-mail: info@bashkia-permet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr 2328/2 prot

Përmet, më 04.08 2025

Në përgjigje të shkresës suaj datë 20.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 2328 prot., datë 21.07.2025, ju informojmë si më poshtë:

1. Cilat njësi administrative (fshatra) u prekën nga zjarret?

Njësitë administrative (fshatrat) e prekura sipas viteve janë:

Viti 2020:

1 rast zjarri në fshatin Badëlonjë, Njësia Administrative Petran

2 raste në fshatin Leusë, Njësia Administrative Petran

Viti 2021:

1 rast në fshatin Kutal, Njësia Administrative Piskovë

1 rast në fshatin Rapckë, Njësia Administrative Piskovë

Viti 2022:

1 rast në fshatin Buhal, Njësia Administrative Piskovë

3 raste në fshatin Leusë, Njësia Administrative Petran

1 rast në fshatin Pëllumbar, Njësia Administrative Çarshovë

Viti 2024:

1 rast në fshatin Çarshovë, Njësia Administrative Çarshovë

2. Sa hektarë pyje u përfshinë nga zjarri në secilën njësi administrative?

2020: 4.2 ha pyje të djegura në Njësinë Administrative Petran

2021: 0.1 ha në Njësinë Administrative Piskovë

2022: 0.3 ha në Njësinë Administrative Piskovë

2023: 0.11 ha në Njësinë Administrative Petran

1 ha në Njësinë Administrative Çarshovë

2024: 4 ha në Njësinë Administrative Çarshovë

3. Sa hektarë konsiderohen të djegura për secilën zonë (ekonomi pyjore)?

2021: 12 ha në fshatin Kutal, Nj.A. Piskovë, Ekonomia Pyjore Lomnicë, ngastra 220a ("Kodrat e Sukut")

Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel. +35581322254; ëb: ëëë.bashkiapermet.gov.al; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

2022: 1 ha në fshatin Leusë, Nj.A. Petran, ngastra nr. 119, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala

2024: 4 ha në fshatin Çarshovë, Nj.A. Çarshovë, ngastrat 237, 238a, Ekonomia Pyjore Petran-Çarshovë

4. Sa prej tyre kanë qenë halorë dhe sa fletorë për secilën zonë?

2020: 4 ha pyje fletorë (prona private), fshati Badëlonjë, ngastra nr. 135, Ekonomia Pyjore Nemërçkë

0.2 ha pyje halorë, fshati Leusë, ngastra nr. 117, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala

2021: 5.5 ha pyje fletorë dhe 6.5 ha halorë, fshati Kutal, ngastra 220a, Ekonomia Pyjore Lomnicë

0.1 ha pyje fletorë, fshati Rapckë, ngastra nr. 78, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala

2022: 0.3 ha pyje fletorë, fshati Buhal, ngastra nr. 76, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala

1 ha pyll fletorë, fshati Pëllumbar, ngastra nr. 66, Ekonomia Pyjore Nemërçkë

Në fshatin Leusë:

0.11 ha pyje halorë, ngastrat 117, 119, Ekonomia Pyjore Nemërçkë

0.97 ha pyje fletorë dhe 0.03 ha pyje halorë

2024: 4 ha pyje fletorë, fshati Çarshovë, ngastrat 237, 238a, Ekonomia Pyjore Petran-Çarshovë

5. Cili ka qenë shkaku i zjarrit në secilën zonë?

Shkaqet mbeten të panjohura, por mendohet të jenë aksidentale ose të qëllimshme për hapje kullotash dimërore.

6. Në cilën periudhë ranë zjarret dhe sa zgjati shuarja e tyre?

Fshati Badëlonjë, Njësia Administrative Petran, Ngastra Nr.135, Ekonomia Pyjore Nemërçkë, shfaqja e zjarrit ,09.01.2020, ora 18⁰⁰, shuarja e zjarrit 10.01.2020, ora 11⁰⁰.

Fshati Leusë Njësia Administrative Petran, Ngastra Nr.117, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala, shfaqja e zjarrit ,17.07.2020, ora 20³⁰, shuarja e zjarrit 17.07.2020, ora 22³⁰

Fshati Leusë Njësia Administrative Petran, Ngastra Nr.117, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala, shfaqja e zjarrit ,31.08.2020, ora 20⁰⁰, shuarja e zjarrit 17.07.2020, ora 22⁰⁰.

Fshati Kutal Njësia Administrative Piskovë, Ngastra Nr.220a, Ekonomia Pyjore Lomnicë, shfaqja e zjarrit ,30.07.2021, ora 18⁰⁰, shuarja e zjarrit 02.08.2021, ora 12³⁰

Fshati Rapckë Njësia Administrative Piskovë, Ngastra Nr.78, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala, shfaqja e zjarrit ,05.09.2021, ora 17⁰⁰, shuarja e zjarrit 05.06.2021, ora 20⁰⁰.

Fshati Buhal Njësia Administrative Piskovë, Ngastra Nr.76, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala, shfaqja e zjarrit ,19.03.2022, ora 12⁰⁰, shuarja e zjarrit 19.03.2022, ora 16⁰⁰.

Fshati Leusë Njësia Administrative Petran, Ngastra Nr.119, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala, shfaqja e zjarrit ,25.03.2022, ora 10³⁰, shuarja e zjarrit 25.03.2022, ora 12³⁰

Fshati Pëllumbar Njësia Administrative Çarshovë , Ngastra Nr.66, Ekonomia Pyjore Nemërçkë, shfaqja e zjarrit ,28.03.2022, ora 15⁰⁰, shuarja e zjarrit 28.03.2022, ora 18³⁰.

Fshati Leusë Njësia Administrative Petran, Ngastra Nr.119, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala, shfaqja e zjarrit ,13.07.2022, ora 17⁰⁰, shuarja e zjarrit 14.07.2022, ora 10³⁰.

Fshati Leusë Njësia Administrative Petran, Ngastra Nr.117, Ekonomia Pyjore Dhëmbel-Kala, shfaqja e zjarrit ,30.07.2022, ora 11⁰⁰, shuarja e zjarrit 30.07.2022, ora 12³⁰.

Fshati Çarshovë Njësia Administrative Çarshovë, Ngastra Nr.237,238a, Ekonomia Pyjore Petran-Çarshovë, shfaqja e zjarrit ,24.08.2024, ora 18⁰⁰, shuarja e zjarrit 25.08.2024, ora 19³⁰.

7. Cili ka qenë dëmi financiar i shkaktuar nga djegia?

Kutal, 2021: 8,750,000 lekë

Leusë, 2022: 56,000 lekë

Çarshovë, 2024: 200,000 lekë

8. Sa ka qenë numri i zjarreve për secilin vit?

2020: 3 raste

2021: 2 raste

2022: 5 raste

2024: 1 rast

9. Sa ka qenë sipërfaqja e pakësuar nga ndryshimi i fondit pyjor për secilin vit?

Nuk ka pasur pakësim të sipërfaqes së fondit pyjor si pasojë e zjarrit — vetëm pakësim në volum.

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi

NËN KRYETAR E SHQIPRISE

Florand HASANI

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel. +35581422254; faks: 000, bashkiapermet.gov.al; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA PËRMET

№ 387/prot

Përmet, më 06.08.2025

Lënda : Përgjigje ndaj kërkesës për informacion mbi mirëqenien e kafshëve shoqëruese në
Bashkinë Përmet

Në përgjigje të shkresës suaj datë nr 82 prot date 24.07.2025 protokolluar me tonën me nr 2387 prot datë 25.07.2025 ju informojmë se aktualisht Bashkia Përmet është në proces pune për hartimin dhe përmirësimin e politikave dhe strukturave që lidhen me menaxhimin e kafshëve endacake dhe mirëqenien e tyre.

Në territorin e bashkisë sonë ekziston një strehë për kafshët endacake, por ajo nuk është ende funksionale. Jemi në fazën e vlerësimit të nevojave dhe mundësive për ta bërë funksionale këtë strehë dhe për të garantuar shërbime të standardizuara për kujdesin ndaj kafshëve.

Duke marrë parasysh përvojën shumëvjeçare që organizata juaj ka në këtë fushë, jemi të hapur për të bashkëpunuar dhe për të mësuar nga praktikat më të mira që ju mund të ndani me ne, me qëllim që të ndërtojmë një qasje më efikase dhe humane ndaj mirëqenies së kafshëve në Përmet. Për çdo komunikim të mëtejshëm teknik dhe informacion shtesë, ju ftojme të kontaktoni veterinerin e bashkisë sonë, z. Erdi Gurra:

☎ Telefon: 068 468 1117

✉ Email: erdigura123@gmail.com

Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel.+35581322254; web: bashkiapermet.gov.al; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

Gjithashtu, ju falenderojmë për pjesën në workshopin që do të zhvillohet më 3 tetor 2025. Do të ishte e vlefshme për ne që të marrim pjesë dhe të përfshihemi në diskutime për zhvillimin e politikave të përbashkëta në këtë fushë.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETAR I BASHKISË

Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi

NËN KRYETAR

Florand HASANI



Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel. +35581322254; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al